

PROCESVERBAL
nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 12.12.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Llazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 39-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencës, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 8-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.11.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 38-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.11.2023.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes Institucionit të arsimit të lartë privat Universiteti i Shkupit - Kconje, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP.
4. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të SHTR KTV SHPKNJ Kavadar.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, për shkelje të nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi.
6. Propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 të LSHMAAV.
7. Propozim-vendim për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR XHEZ FM nga Shkupi.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 8-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.11.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 38-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.11.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes Institucionit të arsimit të lartë privat Universiteti i Shkupit - Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP. Ai shpjegoi se sipas LSHMAAV në afat prej 30 ditësh nga fillimi i punës së transmetuesit, Agjencia duhet të kryejë mbikëqyrje profesionale. Gjatë tentativës së parë për takimin e dakorduar me transmetuesin, nuk kishte kush t'i priste punonjësit e Agjencisë për të kryer mbikëqyrjen profesionale. Për të respektuar afatin ligjor, u caktua termin plotësues. Me tentativën e dytë është kryer mbikëqyrje profesionale nga ku u konstatua se ky transmetues nuk i plotëson kushtet minimale teknike dhe hapësinore, që do të thotë se kjo është bazë për fillimin e procedurës për heqjen e lejes.

Udhëheqësi i njësisë për mbështetje informative dhe teknologji mr.Gorjan Sheqerinov sqaroi se së bashku me ndihmës shefin e Sektorit për mbështetje informative dhe çështje të përgjithëshme mr. Argjend Xhelili, në pajtim me nenin 30 të LSHMAAV kanë kryer mbikëqyrje profesionale për kontrollim të kushteve teknike dhe hapësinore të radiodifuzerit gjatë transmetimit të programit. Ajo që u konstatua ishte se nuk kishte pajisje për transmetimin e programit, studio që ishte parashtruar në dokumentacionin teknik nuk korrespodonte me atë që u gjet në vend. Nuk kishte ndarje, nuk kishte zyrë të regjisë, zyrë të sallës së serverit dhe as pajisjet e shënura në specifikacionin teknik nuk ekzistonin. Në këtë drejtim është kërkuar nga personi përgjegjës që të paraqesë informacion, gjegjësisht dëshmi se kanë ndonjë pajisje, sepse në atë moment në radio, transmetohej program. Personi përgjegjës dorëzoi ofertë për pajisje teknike e cila nuk korrespodonte me specifikacionin e dorëzuar në Agjencion, ndërsa për programin ka shpjeguar se po transmetohet nga tjetër vend.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio, Institucionit të arsimit të lartë Universiteti i Shkupit - Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP, PA1 nr.08-333 datë 09.10.2023, për shkak se kushtet teknike dhe hapësinore të transmetuesit nuk janë në pajtueshmëri me kushtet teknike dhe hapësinore të ofruara në procedurën për dhënien e lejes nr.08-333 datë 09.10.2023, të cilat janë paraqitur në Formularin nr.2 të Aplikimit për dhënien e lejes.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk i harmonizon kushtet hapësinore dhe teknike me kushtet e ofruara hapësinore dhe teknike në procedurën për dhënien e lejes, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio Institucionit të arsimit të lartë privat Universiteti i Shkupit - Shkupit, Institucion

radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP, PA1 nr.08-333 datë 09.10.2023, për shkelje të nenit 30 paragrafi (1) të LSHMAAV, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 83 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë.

Pika 4

Z. Trajkovski shpjegoi Propozim-aktvendimin për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve të SHTR KTV SHPKNJP Kavadar. Ai shpjegoi se ky radiodifuzer e ka kthyer lejen sepse ka ndëruarr mjetin teknik të transmetimit të programit, gjegjësisht nga multipleks digjital tokësor, tani transmeton program nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik sepse ka leje të re për transmetim televiziv. Në pajtim me Ligjin, hapi i radhës është të fshihet nga regjistri i radiodifuzerëve.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar, me Leje nr. ynë PA1 nr.08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendimin, nr.ynë PA1 nr.08-258 datë 15.08.2023.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë, aktvendimin e mësipër ta publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, për shkelje të nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe të nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi. Ajo shpjegoi se mbikëqyrje e rregullt është kryer më 7 nëntor të këtij viti, nga ku u konstatua se nuk janë respektuar kushtet për reklamim dhe teleshoping. Në edicione të shumta të filmave artistik të transmetuara në ditën e analizës është konstatuar se radiodifuzeri në mënyrë joadekuate shfrytëzon teknika të reja reklamimi, reklama në ekran të ndarë, ku mbulon pjesë thelbësore të veprimit dramatik. Për këto arsye propozohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë vërejtje publike me afat harmonizimi prej 10 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse ka harmonizuar punën e tij me dispozitat e nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe të nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi. Ajo informoi se TV Alsat-M dërgoi daklaratë në të cilën thuhet se pajtohet me vërejtjet e AVMU-së dhe njofton se menjëherë do t'i mënjanon.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4472/1 datë 01.12.2023 dhe njëzëri konkludoi që SHTR ALSAT-M SHPK Shkup t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkeljen e nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi, sepse më 7 nëntor 2023, në edicionet e filmave artistik „Mos më braktis“, „Çakër-familja e madhe“ dhe „Vajza ime e vogël“, janë transmetuar pop-ap/reklama në ekran të ndarë që mbulon pjesë thelbësore të veprimit dramatik.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë

07.11.2022, është udhëzuar në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 98 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe të nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipër ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Z. Trajçevski shqjgoi Propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 të LSHMAAV. Ai shqjgoi se operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe operatorët satelitorë si operatori në fjalë TOTAL TV janë të detyruar t'i transmetojnë të gjitha shërbime programore të shërbimit publik radiodifuziv. Nga mbikëqyrja është konstatuar se ritransmeton vetëm TVM1 ndërsa shërbimet e tjera programore „TVM 2“, „TVM 3“, „TVM 4“ dhe „TVM 5“ nuk i transmeton. Meqënëse shkelja është përsëritur më shumë se një herë këtë vit, propozohet ngritja e procedurës për kundërvajtje.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt programore nr.11-4338/1 datë 22.11.2023, Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, dhe konstatoi shkelje të nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup të ngrejë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja është konstatuar se operatori në fjalë i rrjetit publik të komunikimit elektronik që sipas notifikacionit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryen veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në paketën e tij programore nuk i ka ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, gjegjësisht nuk kryen ritransmetimin e shërbimeve programore „TVM 2“, „TVM 3“, „TVM 4“ dhe „TVM 5“ që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike të hartojë Kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për operatorin në fjalë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr.Magdalena Davidovska Dovleva, shqjgoi Propozim-vendimin për ndyshimin e strukturës së pronësisë të SHTR XHEZ FM nga Shkupi. Ajo shqjgoi se ndryshimi i planifikuar i referohet daljes së plotë nga pronësia e pronarit aktual të këtij radiostacioni dhe ardhjes së një personi tjetër fizik. Njoftimi është i plotë dhe i rregullt, dhe gjatë kontrollit në Regjistrin Qendror të RMV-së,

personi që duhet të jetë pronari i ri i radios paraqitet si pronar, ortak dhe drejtues në pesë shoqëri tregtare, por asnjëra prej tyre nuk është regjistruar për ndonjë nga këto veprimtari të transmetuesit, gjë që do të krijonte përqëndrim të paligjshëm mediatik. Në këtë drejtim, propozimi është që të miratohet Vendim me të cilin do të miratohet ndryshimi i planifikuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejohet ndryshim në strukturën e pronësisë të SHTR Xhez FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, me tekstin e propozuar në vendim.

Me ndryshimet e propozuara të strukturës së pronësisë të SHTR Xhez FM Ljupço SHPKNJP-Shkup, nuk krijohet përqëndrim i paligjshëm mediatik në kuptim të LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën të Ndryshme.

Nr.02-4550/7

22.12.2023
Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI